

## Përmbillet me sukses në Universitetin e Elbasanit, Java Ndërkombëtare Erasmus+

Përmbillet me sukses në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Java Ndërkombëtare Erasmus+, organizuar në bashkëpunim me Universidad de Jaén, një aktivitet në kuadër të programit Erasmus+ KA171.

Ky aktivitet njëjavor solli bashkëpunim akademik të frytshëm, duke ofruar mundësi të reja për mobilitet, zhvillim profesional për personelin akademik të UE-së, iniciativa për bashkëpunime në projekte të reja, kërkim shkencor, mundësi për studentët e shumë të tjera.

Në ceremoninë përmbyllëse, Zëvendësrektori për Ndërkombëtarizim në Universidad de Jaén, Prof.dr. José Ignacio Jiménez González dhe Zëvendësrektorja e Universitetit të Elbasanit, Prof.as.dr Rezarta Tahiraj, shpërndanë certifikata për pjesëmarrësit, duke vlerësuar angazhimin dhe kontributin e tyre në këtë iniciativë ndërkombëtare.

Kjo javë konfirmoi edhe një herë rëndësinë e programit Erasmus+EU në ndërtimin e urave të bashkëpunimit mes institucioneve akademike dhe krijimin e mundësive të reja për edukim dhe eksperiencë ndërkombëtare.







